



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 152, Datë 03.07.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË  
“RENERGY TRADING GROUP” SH.P.K., PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E  
TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, dhe nenit 10, pika 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 03.07.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Renergy Trading Group” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 465 datë 22.06.2017, shoqëria “Renergy Trading Group” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “Renergy Trading Group” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” si më poshtë:
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2). Plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3). Plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.8). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të *“Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Renergy Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.